



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 14.08.2019

Ref: 1447/130

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016) Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), mori:

V E N D I M

Për korrigjimin (përmirësim) e vendimit Nr. 429/12, datë 09.07.2012 të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës

Korrigjohet (ndryshohet) vendimi i KShC-së Nr. 429/12, datë 09.07.2012 të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në pikën I.

- I. Korrigjohet (ndryshohet) pika I e vendimit të KShC-së Nr. 429/12, datë 09.07.2012, ku vendimit ekzistues për akreditim të programeve të studimit i shtohen edhe programet në vijim:
 1. E drejta civile dhe pronësore (LLM);
 2. E drejta ndërkombëtare (LLM).
- II. Pjesa tjetër e vendimit të KShC-së Nr. 429/12, datë 09.07.2012, mbetet e pa ndryshuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


Arsyetimi

Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës ka parashtruar kërkesë (nr. 1055H/19, datë 28.06.2019) për përmirësim të vendimit të KSHC-së Nr. 429/12, datë 09.07.2012, në pikën një. Pas dëshmive të ofruara dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, dhe pas verifikimit të raportit të ekspertëve ndërkombëtarë, bazuar në kërkesën e cekur më sipër dhe nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016), Agjencia e Kosovës për Akreditim ka trajtuar kërkesën në fjalë, dhe me këtë rast vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

